

Ministria për Fëmijët, Familjen, Refugjatët dhe Integrimin e Landit Nordrhein-Westfalen



08.04.2021

Informacione për prindërit

fëmijët e të cilëve ndodhen nën kujdestarinë e qendrave të kujdesit ditor për fëmijë ose nën përkujdesje ditore për fëmijë

Informacione për bartësit, strukturat drejtuese, personelin

e qendrave të kujdesit ditor për fëmijë ose qendrave për përkujdesje ditore për fëmijë.

Përkujdesi ditor i fëmijëve dhe vetë-testimet nga data 12 Prill 2021

Përkujdesi ditor i fëmijëve në Nordrhein-Westfalen do të vazhdojë të qëndrojë në veprim të rregullt të kufizuar edhe pas datës 11 Prill 2021 deri në një njoftim të ri. Vijnë të mbeten të vlefshme rregullat e renditura në informacionin zyrtar të 26 Marsit 2021.

Funksionimi i kufizuar i rregullit nga 12 Prilli 2021 do të shoqërohet nga një ofertë gjithëpërfshirëse testimi. Të gjithë fëmijëve dhe punonjësve në qendrën e kujdesit ditor si edhe personelit të qendrës së përkujdesit ditor në rang Landi, do të pajisen me vetë-teste. Fëmijët do të testohen në shtëpi nga prindërit. Përdorimi i vetë-testeve bëhet në baza vullnetare.

Përveç respektimit të masave të rrepta të higjienës dhe vaksinimeve të punonjësve dhe të personelit të përkujdesit ditor të fëmijëve, përsëri opsioni i testit është një tjetër komponent i rëndësishëm, me qëllim që të rritet më tej mbrojtja shëndetësore dhe mbrojtja ndaj infeksionit, dhe në këtë mënyrë të ruhet funksionimi i përkujdesit ditor të fëmijëve. Vaksinimet do të vazhdojnë sipas udhëzimeve të Ministrisë përgjegjëse të Punës, Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale.

Paraqitja e rezultatit të testit nuk është një parakusht për të filluar punën ose për të përfituar nga oferta për përkujdesje.

Informacione lidhur me vetë-testin

Do të bëhet furnizimi me të ashtuquajtura teste të shpejta antigen, të cilët pas 15 minutash japin informacionin, nëse një person në kohën e testimit është i infektuar. Testet e siguruara nga MKFFI-ja janë teste për vetë-përdorim që janë lejuar nga Instituti Federal për Barnat dhe Produktet Mjekësore për vetë-përdorim nga amatorët.

Vetë-testet e vëna në dispozicion, kryhen duke marrë një analizë në pjesën e përparme të hundës. Udhëzuesi i bashkëngjitur si shtojcë përmban një Kod QR për këtë video trajnimi:

https://h5.9fm.cn/jssg46?url=e666G_bDxSP2G

Ky udhëzim mund të shkarkohet edhe këtu:

<https://www.mkffi.nrw/corona-aktuelle-informationen-fuer-die-kindertagesbetreuung>

Disponimi dhe sasia e vetë-testeve

Në javën duke filluar nga 12 Prilli 2021, vetë-testet e para do t'u shpërndahen qendrave të kujdesit ditor për fëmijët dhe personelit të qendrave të përkujdesit ditor përmes bartësve dhe qendrave në përkujdesje të të miturve. Paralelisht, fillojnë dërgesat e mëtejshme, të cilat vijojnë drejtpërdrejt tek institucionet. Për qendrat e përkujdesit ditor të fëmijëve, dërgesat do të vazhdojnë të vijojnë tek qendrat në përkujdesje të të miturëve. Ministria ka porositur teste në sasi të mjaftueshme. Sidoqoftë, nuk mund të përjashtohet mundësia që mund të krijohen vonesa në kohë ose devijime të vogla në furnizime.

Janë planifikuar dy vetë-teste për person në javë si për punonjësit ashtu edhe për fëmijët. Shpërndarja e testeve tek punonjësit dhe prindërit duhet të bëhet nga institucionet me përgjegjësinë e tyre.

Fillimisht, vihen në disponim njësitë e paketimit me pesë teste, të cilat duhet të shpërndahen në mënyrë të përshtatshme. Në vazhdim, duhet të bëhet dorëzimi i paketave për copë.

Vendi dhe koha e testimeve vullnetarisht

Punonjësit duhet të bihen dakort me bartësit për vendin dhe kohën e vetë-testimeve. Punonjësit e pavarur të përkujdesit ditor të fëmijëve vendosin me përgjegjësinë e tyre.

Prindërit testojnë fëmijët e tyre në shtëpi përmes vetë-testeve që u janë vënë në disponim dhe vendosin me përgjegjësinë e tyre se kur do të testojnë fëmijët e tyre.

Procedimi me rezultatet e testeve

Nëse rezultati i një testi është pozitiv, punonjësit ose personat e përkujdesit ditor për fëmijët nuk lejohen të kujdesen për fëmijët. Fëmijët, që rezultojnë pozitiv nuk lejohen të frekuentojnë qendrën e përkujdesit ditor për fëmijë.

Rezultati pozitiv i vetë-testit nuk çon në detyrimin për të njoftuar autoritetin shëndetësor. Sidoqoftë, duhet bërë menjëherë një PCR-Test në një qendër testimi ose tek mjekja ose mjeku i familjes. Duhet të shmangen të gjitha kontaktet dhe të qëndrohet në karantinë në shtëpi deri në ditën e testimit. Në rast të një dëshmimi pozitiv i PCR-së, hapat e mëtejshme kryhen në përputhje me rregullat e Landit ose në përputhje me urdhërin e autoriteteve lokale përgjegjëse. Kjo vlen edhe për kthimin e fëmijës në qendrën e shërbimit të kujdesit ose për rifillimin e punës nga ana e punonjësve.

Ministria për Fëmijët, Familjen, Refugjatët dhe Integrimin e Landit Nordrhein-Westfalen